

Informacion për pjesëmarrësit në studim

Qendra Kombëtare për Kërkime Sociale (NatCen) po kryen kërkime për të kuptuar **eksperiencat e njerëzve lidhur me ardhjen në MB dhe lidhur me sistemin e emigracionit.**

Ne dëshirojmë të flasim me ju nëse:

- keni ardhur në MB **në ose pas muajit janar 2023** DHE/OSE DHE/OSE
- jeni referuar në **Mekanizmin Kombëtar të Referimit për viktimat e mundshme të trafikimit në ose pas muajit janar 2023**

Ky studim financohet nga **Ministria e Brendshme** (Home Office), por NatCen është një organizatë **e pavarur**. Kjo do të thotë se **ne nuk jemi pjesë e Ministrisë së Brendshme** apo qeverisë dhe **nuk marrim vendime nëse personat mund të qëndrojnë në MB.**

Çfarë duhet të bëj?

Pjesëmarrja do të përfshinte një intervistë kërkimore.

- Intervista do të jetë me **një studiues nga NatCen** dhe do të zgjasë **60-90 minuta**.
- Ju mund ta bëni intervistën në **një gjuhë tjetër përveç anglishtes** nëse dëshironi. Ne do të përdorim një përkthyes.
- Mund të keni dikë me vete për t'ju mbështetur nëse dëshironi.
- Mund të zgjidhni ta bëni intervistën **me telefon, me video-telefonatë ose personalisht** në kohën që ju përshtatet.
- **Nëse jeni dakord, ne do ta regjistrojmë** intervistën për të siguruar që asgjë nga ju të mos harrohet.
- Do të merrni një **kupon blerjeje prej £40** për t'ju falënderuar për kohën tuaj.
- Ne mund t'ju kërkojmë të merrni pjesë në studime të mëtejshme për të mësuar më shumë rreth përvojave tuaja.

Për çfarë do të më pyesni?

Përpara intervistës, ne do t'ju bëjmë disa pyetje rreth vetes tuaj, kur keni mbërritur, dhe aplikimit tuaj për emigracion, për t'u siguruar që pyetjet tona janë të përshtatshme për juve.

Gjatë intervistës do t'ju pyesim për:

- Udhëtimin juaj për në MB
- Çfarë ka ndodhur që kur keni ardhur, duke përfshirë përvojën tuaj me sistemin e emigracionit

Ne nuk do t'ju bëjmë pyetje për atë që ju ka ndodhur në vendin tuaj të origjinës. Intervista kërkimore nuk është një intervistë emigracioni – ajo nuk bën pjesë në çështjen tuaj. **Ne nuk marrim vendime nëse personat mund të qëndrojnë në MB dhe as nuk do të ndajmë informacion nga kjo intervistë me personat që marrin atë vendim.**

Ju mund të zgjidhni të mos i përgjigjeni ndonjë pyetjeje që nuk dëshironi.

A duhet të marr pjesë?

Ju **nuk keni pse të merrni pjesë** nëse nuk dëshironi. Pjesëmarrja ose mosmarrja **nuk do të ketë ndikim mbi çështjen tuaj të emigracionit** ose në të drejtën tuaj për të qëndruar këtu tani ose në të ardhmen.

Ju mund **të zgjidhni të mos i përgjigjeni në ndonjë pyetjeje që nuk dëshironi** dhe mund **të kërkonit që të dhënat tuaja të hiqen nga studimi** deri në 6 javë pas intervistës, pa dhënë arsye.

Çfarë do të ndodhë me informacionin që ju jap?

Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, të gjitha informacionet që jepni do të mbahen në konfidencë të rreptë, do të ruhen në mënyrë të sigurt dhe do të fshihen në fund të projektit. Ne do të shkruajmë një raport për Ministrinë e Brendshme për çështjet kryesore të diskutuara nga ju dhe të tjerët në rrethana të ngjashme. Ne **nuk do t'i tregojmë askujt**, përfshirë Ministrinë e Brendshme, se kush ka marrë pjesë ose çfarë kanë thënë pjesëmarrësit individualë. Ne **nuk do të përfshijmë asnjë emër, numër reference çështjeje apo detaje specifike** në raport.

Informacione të mëtejshme rreth mënyrës se si ne përdorim dhe ruajmë të dhënat tuaja jepen te [www.natcen.ac.uk/migrantexperiences/privacynotice]

Ku mund të marr mbështetje me çështjen time?

Organizatat e mëposhtme do të jenë në gjendje të ofrojnë mbështetje ose informacion në lidhje me sistemin e emigracionit.

Migrant Help (Mbështetja ndaj migrantëve)

Faqja e internetit: www.migranthelpuk.org

Linja e ndihmës (telefon falas 24 orë në ditë): 0808 8010 503

Email: kontaktoni Migrant Help nëpërmjet [webchat](#) ose me [online enquiry form](#).

Refugee Council (Këshilli i Refugjatëve)

Faqja e internetit: www.refugeecouncil.org.uk

Linja e ndihmës (9:30 paradite -12:30 pasdite; e hënë - e enjte): 0808 196 7272

Email: refugeeadvice@refugeecouncil.org.uk

Samaritans (Samaritanët)

Faqja e internetit:: www.samaritans.org

Linja e ndihmës (telefon falas, 24 orë në ditë): 116 123

Email: jo@samaritans.org

Na kontaktoni

Nëse **keni ndonjë pyetje ose dëshironi të ndryshoni orën e intervistës**, ju lutemi na kontaktoni.

- migrantresearch@natcen.ac.uk
- 0808 168 2791
- www.natcen.ac.uk/migrantexperiences

Numri i vendeve në këtë studim është i kufizuar. Kjo do të thotë që **mund të jetë e pamundur të intervistojmë të gjithë personat që na thonë se duan të marrin pjesë.**